

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Fakulteti i Studimeve Islame (FSI)

Plani Strategjik i Fakultetit të Studimeve Islame 2026-2030



Përmbajtja

Lista e Shkurtesave	4
Përmbledhje Ekzekutive	5
1. Hyrje.....	6
1.1. Infrastruktura akademike, burimet dhe kapaciteti institucional	7
1.2. Rëndësia e planifikimit strategjik për FSI-në	8
1.3. Qëllimet dhe parimet udhëheqëse të planit	8
2. Metodologjia e Hartimit të Planit Strategjik.....	9
2.1. Procesi pjesëmarrës dhe roli i Grupit të Punës	10
3. Analiza e Gjendjes.....	11
3.1. Kuadri ligjor dhe institucional në Kosovë	12
3.2. Studentët, stafi dhe programet akademike.....	12
3.3. Sfidat dhe mundësitë e mjedisit	13
3.4. Analiza SWOT	14
4. Vizioni, Misioni dhe Vlerat.....	16
4.1. Vizioni i FSI	16
4.2. Misioni i FSI	16
4.3. Vlerat e FSI.....	17
5. Objektivat Zhvillimore	18
1. Përmirësimi i cilësisë akademike dhe inovacionit në mësimdhënie	18
2. Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore dhe publikimeve shkencore	20
3. Ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi institucional.....	22
4. Forcimi i lidhjes me komunitetin dhe tregun e punës	23
5. Zhvillimi institucional dhe qëndrueshmëria	25
6. Zbatimi, Monitorimi dhe Vlerësimi i Strategjisë	27
6.1. Mekanizmat për Zbatim.....	27



6.2. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi	28
7. Ndikimi Buxhetor i Strategjisë	29
7.1. Burimet e financimit	30
7.2. Qëndrueshmëria financiare	30

Lista e Shkurtesave

Shkurtesa	Përshkrimi
FSI	Fakulteti i Studimeve Islame
MAShTI	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
EHEA	Zona Evropiane e Arsimit të Lartë
KPI	Treguesit Kyç të Performancës
GP	Grupi i Punës
KMZS	Komisioni për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Strategjisë
KKK	Korniza Kombëtare e Kualifikimeve
SHER	Arsimi i Lartë dhe Kërkimi i Qëndrueshëm në Kosovë
BIK	Bashkësia Islame e Kosovës
ESG	Standardet dhe Udhëzuesit Evropianë për Sigurimin e Cilësisë
EQAR	Regjistri Evropian i Sigurimit të Cilësisë
UP	Universiteti i Prishtinës
AKA	Agjencia e Kosovës për Akreditim
SIMS	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Studentëve
TI	Teknologji Informative
Erasmus+	Program i BE për arsim, trajnim, rini dhe sport
Horizon Europe	Programi i Bashkimit Evropian për Kërkim dhe Inovacion

Përmbledhje Ekzekutive

Plani Strategjik 2026–2030 i Fakultetit të Studimeve Islame (FSI) në Prishtinë paraqet orientimin e ri zhvillimor të FSI-së për pesë vitet e ardhshme, duke përcaktuar vizionin, misionin, vlerat dhe drejtimet kryesore strategjike për modernizimin dhe forcimin e rolit të FSI-së në arsimin e lartë dhe shoqëri. Dokumenti është hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, të udhëhequr nga Grupi i Punës i FSI-së dhe i mbështetur nga projekti SHER, duke kombinuar analiza institucionale, konsultime të gjera dhe praktika ndërkombëtare të planifikimit strategjik.

Plani bazohet në tri shtyllat themelore të institucioneve të arsimit të lartë: mësimdhënie cilësore, kërkim shkencor dhe shërbim ndaj komunitetit. Për të realizuar këto shtylla, strategjia përcakton pesë objektiva zhvillimorë:

1. **Përmirësimi i cilësisë akademike dhe inovacionit në mësimdhënie** – duke modernizuar kurrikulën, integruar mësimin digjital, përforcuar trajnimin e stafit dhe rritur përfshirjen e studentëve.
2. **Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore dhe publikimeve shkencore** – përmes rritjes së produktivitetit shkencor, përfshirjes së studentëve në hulumtim, mbështetjes për publikime dhe forcimit të kërkimit shkencor.
3. **Ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi institucional** – përmes marrëveshjeve të reja ndërkombëtare, mobilitetit akademik dhe të studentëve, pjesëmarrjes në projekte evropiane dhe organizimit të aktiviteteve ndërkombëtare.
4. **Forcimi i lidhjes me komunitetin dhe tregun e punës** – duke zgjeruar partneritetet me BIK-un, shkollat, komunat, organizatat publike dhe duke rritur rolin e FSI-së në dialogun ndërfetar, etikën profesionale dhe edukimin qytetar.
5. **Zhvillimi institucional dhe qëndrueshmëria** – përmes digjitalizimit, modernizimit të infrastrukturës, forcimit të cilësisë së brendshme, diversifikimit të burimeve të financimit dhe ngritjes së kapaciteteve të stafit.

Strategjia përcakton masa konkrete dhe indikatorë matës për secilin objektiv, duke mundësuar një qasje sistematike në vlerësimin e progresit dhe të siguroj transparencë dhe llogaridhënie institucionale. Në aspektin financiar, plani parashikon kombinimin e burimeve të brendshme me financime të jashtme përmes programeve ndërkombëtare, partneriteteve, fondeve të donatorëve dhe të ardhurave vetanake. Kjo qasje synon garantimin e qëndrueshmërisë afatgjatë dhe mbështetjen e objektivave zhvillimore.

Plani Strategjik 2026–2030 e pozicionon FSI-në drejt një transformimi të qëndrueshëm akademik e institucional, duke synuar cilësi më të lartë, ndikim shoqëror më të thellë, shtrirje ndërkombëtare më të gjerë dhe funksionim modern të mbështetur në parime të integritetit, inovacionit dhe përfshirjes.

1. Hyrje

Fakulteti i Studimeve Islame (FSI) është institucion i pavarur edukativ-arsimor dhe mësimor-shkencor, i cili është themeluar me vendimin nr.443 të “Kuvendit të Bashkësisë Islame të Republikës së Kosovës, të datës 15.08.1992. FSI është një institucion i arsimit të lartë në Kosovë me një traditë të gjatë në formimin akademik dhe profesional të kuadrove në fushën e studimeve islame, shkencave humane dhe shërbimit ndaj komunitetit. Si një institucion që kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin edukativ, kulturor dhe shoqëror të vendit, FSI luan një rol të rëndësishëm në përgatitjen e profesionistëve të kualifikuar për institucionet fetare, arsimore dhe komunitare.

Ndryshimet e fundit në sistemin e arsimit të lartë, rritja e kërkesave për cilësi akademike, nevoja për modernizim të metodave të mësimdhënies, forcimi i kërkimit shkencor dhe trendet e ndërkombëtarizimit kërkojnë një qasje të re strategjike për zhvillimin e FSI-së. Po ashtu, transformimi i vazhdueshëm i tregut të punës, digjitalizimi dhe dinamika shoqërore e kulturorë vendosin para fakultetit sfida dhe mundësi që kërkojnë orientim të qartë strategjik.

Në këtë kontekst, Plani Strategjik 2026–2030 është hartuar për të udhëhequr zhvillimin institucional, për të përmirësuar performancën akademike, administrative dhe kërkimore, si dhe për të forcuar rolin e FSI-së në shoqëri.

Diagrami më poshtë paraqet strukturën menaxhuese të FSI-së, duke ilustruar organet kryesore drejtuese dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.




Figura 1: Struktura menaxhuese e Fakultetit të Studimeve Islame.

Struktura qeverisëse e FSI-së bazohet në dy autoritete kryesore: Këshillin Mësimor-Shkencor dhe Dekanin.

Këshilli Mësimor-Shkencor është organi më i lartë vendimmarrës, përgjegjës për politikat akademike, financiare dhe infrastrukturore të fakultetit. Dekani, si udhëheqës akademik dhe administrativ, siguron funksionimin efikas të Fakultetit dhe raporton para Këshillit. Dekanin e mbështesin Prodekani, Sekretari dhe Zyra për Sigurim të Cilësisë.

Në kuadër të FSI-së funksionon edhe Unioni i Studentëve, i cili lehtëson komunikimin student-staf dhe kontribuon në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Fakulteti përbëhet nga njësi akademike me dy programe studimi (BA dhe MA në Teologji Islame) dhe një sërë njësish organizative që mbështesin funksionimin ditor, përfshirë Zyrën e Dekanit, Zyrën e Sekretarit, Shërbimin e Studentëve, Bibliotekën, Zyrën e Cilësisë, Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Shërbimin IT. Fakulteti mbështetet gjithashtu nga Bordi Këshillëdhënës me ekspertë ndërkombëtarë.

Ky organizim siguron një strukturë efikase, transparente dhe në funksion të misionit akademik, kërkimor dhe komunitar të FSI-së.

1.1. Infrastruktura akademike, burimet dhe kapaciteti institucional

Fakulteti i Studimeve Islame ofron studime në dy programe të akredituara: Bachelor dhe Master në Teologji Islame. Aktualisht, në FSI studiojnë rreth 410 studentë të rregullt dhe jo të rregullt, ndërsa procesi akademik mbështetet nga 26 anëtarë të stafit akademik dhe 6 staf administrativ.

FSI disponon infrastrukturë moderne dhe të mirëmbajtur, me një sipërfaqe totale prej 3,474.08 m². Sallat e mësimi janë të pajisura me tabela të mençura dhe internet, ndërsa amfiteatri dhe laboratoritë e kompjuterëve ofrojnë kushte të avancuara për zhvillimin e mësimi. Objekti është plotësisht i qashtë edhe për persona me aftësi të kufizuara, përmes rampave dhe ashensorit.

Biblioteka e fakultetit është një nga asetet kryesore akademike, me rreth 10,000 libra dhe 3,500 tituj, si dhe qindra punime diplome. Ajo ofron literaturë në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaja, qasje elektronike për katalogimin dhe menaxhimin e resurseve, si dhe funksionim me orar të zgjatur për të mbështetur studentët gjatë gjithë vitit akademik. FSI ka gjithashtu një bashkëpunim ndërkombëtar me Bibliotekën Aleksandria në Egjipt, që lehtëson qasje në burime të avancuara kërkimore.

FSI zbaton mekanizma të rregullt të sigurimit të cilësisë, përfshirë pyetësorët semestralë, takimet me studentët dhe mbledhjen sistematike të feedback-ut. Inventarizimi i pajisjeve kryhet çdo vit për të siguruar menaxhimin efektiv të burimeve, ndërsa stafi teknik garanton mbështetje të vazhdueshme për përdorimin e teknologjisë në mësimdhënie dhe kërkim.

1.2.Rëndësia e planifikimit strategjik për FSI-në

Planifikimi strategjik është një proces thelbësor për FSI-në, sepse siguron një drejtim të qartë afatgjatë, përmirëson cilësinë e vendimmarrjes dhe përdorimit të burimeve, siguron përputhshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë, nxit transparencën dhe llogaridhënien, rrit efektshmërinë e shërbimeve akademike dhe administrative dhe e ndihmon institucionin të përgjigjet në mënyrë adekuate ndaj zhvillimeve të shpejta sociale, teknologjike dhe ekonomike. Për FSI-në, planifikimi strategjik ka rëndësi të veçantë sepse mundëson përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimin e kërkimit shkencor, forcimin e rolit të fakultetit në komunitet, modernizimin e kapaciteteve institucionale, rritjen e ndërkombëtarizimit dhe të bashkëpunimeve, si dhe sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm financiar dhe organizativ.

1.3.Qëllimet dhe parimet udhëheqëse të planit

Ky dokument synon të përcaktojë vizionin dhe misionin e ri të FSI-së, të identifikojë fushat prioritare të zhvillimit institucional për periudhën 2026–2030, të vendosë objektiva zhvillimore të qarta dhe të matshme, të paraqesë masa dhe indikatorë për monitorimin e secilit objektiv dhe të sigurojë një sistem të qëndrueshëm për zbatimin, monitorimin dhe raportimin e progresit.

Parimet udhëheqëse të hartimit dhe zbatimit të planit janë:

1. **Cilësia akademike** – përmbushja e standardeve akademike dhe sigurimi i përvojës së studentit.
2. **Integriteti dhe profesionalizmi** – etikë akademike dhe transparencë në vendimmarrje.
3. **Përfshirja** – konsultim i vazhdueshëm me aktorët e brendshëm dhe të jashtëm.
4. **Përputhshmëria** – harmoni me kornizën ligjore të MASHTI, standardet e AKA dhe me zonën evropiane të arsimit të lartë.
5. **Zhvillimi i qëndrueshëm** – menaxhim i burimeve dhe plane afatgjata.
6. **Inovacioni** – përdorimi i metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe kërkimit.
7. **Lidhja me komunitetin** – përforcimi i rolit shoqëror të fakultetit.

2. Metodologjia e Hartimit të Planit Strategjik

Metodologjia e hartimit të Planit Strategjik 2026–2030 për FSI-në është ndërtuar mbi parimet e planifikimit modern strategjik në arsimin e lartë. Qasja metodologjike është hartuar për të siguruar që dokumenti të jetë gjithëpërfshirës, realist, i zbatueshëm dhe i bazuar në analiza të sakta të gjendjes aktuale dhe nevojave reale institucionale.

Procesi i hartimit të strategjisë është mbështetur mbi tre parime themelore:

- pjesëmarrjen institucionale,
- pronësinë e plotë nga FSI, dhe
- vendimmarrjen e bazuar në të dhëna dhe evidencë.

Këto parime sigurojnë jo vetëm krijimin e një dokumenti strategjik cilësor, por edhe rritjen e mundësive për zbatim të suksesshëm të tij, duke përfshirë të gjithë aktorët relevantë brenda dhe jashtë institucionit.

Procesi u udhëhoq nga një Grup Pune (GP), i themeluar me vendim të Dekanit të FSI-së. Ky grup në mbështetje nga eksperti i programit të SHER kishte përgjegjësi kryesore për dizajnimin e metodologjisë, koordinimin e mbledhjes së të dhënave, facilitimin e punësive dhe hartimin e draftit të dokumentit. Përfshirja e GP-së garantoj pronësi institucionale në çdo fazë, duke siguruar që strategjia të reflektojë perspektivat e stafit akademik, administrativ, studentëve dhe palëve të interesuara.

Procesi i hartimit u zhvillua në disa faza të ndërlidhura:

Së pari, Grupi i Punës zhvilloi dhe miratoi metodologjinë dhe formatin e dokumentit strategjik, duke përcaktuar strukturën e planit, instrumentet analitike që do të përdoren dhe mënyrën e organizimit të konsultimeve. Kjo fazë shërbeu gjithashtu për të vendosur kategoritë kryesore të të dhënave që do të mbledheshin për analizën fillestare, përfshirë të dhënat akademike, administrative, financiare dhe demografike.

Së dyti, u realizua mbledhja dhe analizimi i të dhënave bazë. Kjo përfshinte historikun e zhvillimit të FSI-së, programet akademike, kapacitetet e stafit, profilin e studentëve, statusin e ndërkombëtarizimit dhe veprimtarinë kërkimore. Një vëmendje e veçantë iu kushtua gjendjes së infrastrukturës, sistemit të sigurimit të cilësisë dhe pozicionimit të FSI-së në kontekstin më të gjerë të arsimit të lartë në Kosovë.

Së treti, u organizua Punësoria e dytë, e cila u përqendrua në analizën SWOT, rishikimin e të dhënave fillestare dhe formulimin e versionit të parë të vizionit, misionit dhe objektivave zhvillimore.

Së katërti, pas punësive së dytë, GP filloi hartimin e draftit të parë të Strategjisë, duke përfshirë objektivat e propozuara, rezultatet e pritshme dhe propozimet fillestare për masat dhe indikatorët. Përgatitja e këtij drafti shërbeu si bazë për punëtorinë e dytë.

Së pesti, u mbajt Punëtorja e tretë, e cila u fokusua në finalizimin e objektivave zhvillimore, definimin e masave kryesore dhe formulimin e indikatorëve të matshëm të performancës (KPI). Kjo fazë ishte thelbësore në sigurimin e zbatueshmërisë dhe relevancës së strategjisë.

Më pas, GP përpunoi versionin e avancuar të Strategjisë, duke inkorporuar të gjitha komentet dhe sugjerimet e mbledhura nga punëtoritë dhe konsultimet. U sigurua që drafti final të ishte koherent, i harmonizuar me strategjitë kombëtare dhe në përputhje me standardet e akreditimit.

Faza e fundit përfshiu procesin e validimit dhe konsultimit të gjerë, në të cilin drafti i Strategjisë iu prezantua komunitetit akademik të FSI-së, alumnive dhe partnerëve institucionalë. Komentet e marra u analizuan dhe, aty ku ishte e nevojshme, u reflektuan në versionin përfundimtar të planit, para miratimit në organet drejtuese të FSI-së.

Kjo metodologji e strukturuar dhe gjithëpërfshirëse garanton që Plani Strategjik 2026–2030 të jetë një dokument i bazuar në evidencë, i zbatueshëm dhe në përputhje me nevojat aktuale dhe aspiratat afatgjata të FSI-së.

2.1.Procesi pjesëmarrës dhe roli i Grupit të Punës

Procesi i hartimit të Planit Strategjik është udhëhequr nga Grupi i Punës (GP), i themeluar nga FSI dhe i mbështetur nga eksperti i angazhuar dhe ekipi i projektit SHER. GP përbëhej nga Dekani, përfaqësues të stafit akademik dhe administrativ.

Grupi i Punës kishte përgjegjësi kyçe në secilën fazë të procesit, duke përfshirë:

- miratimin e strukturës dhe metodologjisë së planifikimit strategjik;
- kontributin në analizën e gjendjes dhe mbledhjen e të dhënave;
- pjesëmarrjen aktive në punëtoritë konsultative;
- propozimin dhe vlerësimin e objektivave zhvillimore;
- shqyrtimin e versioneve të draftit të planit;
- validimin e dokumentit final për dorëzim në organet drejtuese.

Ky proces pjesëmarrës siguroi pronësi të plotë institucionale dhe garantoi që dokumenti final të pasqyrojë qartë prioritetet, kapacitetet dhe vizionin e FSI-së.

Metodologjia është ndërtuar mbi këto parime themelore:

- **Pjesëmarrja** – përfshirja e të gjithë aktorëve relevantë.
- **Transparenca** – vendimmarrja e dokumentuar dhe e hapur.

- **Analiza e bazuar në të dhëna** – vendimet strategjike të mbështetura në evidencë.
- **Qëndrueshmëria** – orientim afatgjatë dhe fokus në zhvillim të qëndrueshëm.
- **Përputhshmëria me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare** – sigurohet integrim i plotë me kornizën ligjore të arsimit të lartë në Kosovë dhe me standardet evropiane.

3. Analiza e Gjendjes

Kapitulli 3 ofron një pasqyrë të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse të gjendjes aktuale të FSI-së, e cila përbën bazën themelore për formulimin e objektivave zhvillimore dhe masave strategjike për periudhën 2026–2030. Analiza është ndërtuar mbi rishikimin e dokumenteve kyçe institucionale, si Plani Strategjik 2021–2025, Statuti i FSI, Raportet e Vetëvlerësimit dhe Raporti Institucional i Vetëvlerësimit 2024, si dhe mbi Analizën SWOT dhe të dhëna të tjera të mbledhura nga struktura akademike dhe administrative.

Në këtë analizë janë inkorporuar gjithashtu trendet kombëtare dhe ndërkombëtare në arsimin e lartë, zhvillimet në kuadrin ligjor të arsimit në Kosovë dhe orientimet e zonës evropiane të arsimit të lartë (EHEA). Kjo qasje siguron që vlerësimi i gjendjes së FSI-së të jetë i integruar dhe i përputhur me standardet moderne akademike dhe kërkesat e sistemit arsimor në vend.

Synimi kryesor i analizës është të paraqesë një pamje të qartë, të balancuar dhe të mbështetur në evidencë të realitetit institucional të FSI-së. Kjo përfshin vlerësimin e kuadrit ligjor dhe institucional ku operon fakulteti, strukturën demografike të studentëve dhe stafit, kapacitetet akademike dhe administrative, burimet infrastrukturore, si dhe pozicionimin e FSI-së në raport me standardet e akreditimit dhe proceset e sigurimit të cilësisë.

Analiza SWOT ka qenë instrument kyç për identifikimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në performancën e FSI-së, duke evidentuar pikat e forta, sfidat, mundësitë për rritje dhe faktorët që kërkojnë ndërhyrje strategjike të menjëhershme.

Procesi analitik është përforcuar përmes metodave të ndryshme, përfshirë analizën e aktorëve të interesit, analizën e trendeve në mësimdhënie, kërkim shkencor, digjitalizim dhe zhvillime në tregun e punës, si dhe intervista të strukturuar me drejtuesit dhe stafin akademik. Punëtoritë konsultative me Grupin e Punës dhe pjesëmarrës të tjerë institucionalë dhe komunitarë kanë ndihmuar në identifikimin e prioriteteve dhe orientimeve të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm të fakultetit.

Këto elemente të kombinuara përbëjnë bazën faktike dhe analitike mbi të cilën është ndërtuar Plani Strategjik 2026–2030, duke siguruar që strategjia e re të jetë e orientuar drejt evidencës, realitike dhe e përputhshme me standardet e arsimit të lartë në Kosovë dhe me praktikën më të mira ndërkombëtare.

3.1. Kuadri ligjor dhe institucional në Kosovë

Fakulteti i Studimeve Islame (FSI) funksionon si institucion i pavarur edukativ-arsimor dhe mësimor-shkencor, i themeluar me vendimin nr. 443 të Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës më 15.08.1992 dhe i rregulluar nga Statuti i tij, si dhe nga legjislacioni kombëtar për arsimin e lartë. Në bazë të Statutit, FSI ka mandat të qartë për të ofruar arsim të lartë në fushën e studimeve islame, për të zhvilluar kërkime shkencore dhe për të kontribuar në shërbimin komunitar, duke respektuar parimet e integritetit akademik, profesionalizmit dhe përputhshmërisë me standardet bashkëkohore.

Në nivel shtetëror, FSI operon brenda kuadrit të përcaktuar nga Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, udhëzimet administrative të MASHTI-it, standardet evropiane për sigurimin e cilësisë (ESG) dhe Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK). Këto dokumente sigurojnë bazën ligjore për funksionimin, akreditimin, hartimin e programeve, transparencën institucionale dhe llogaridhënien publike. Strategjia e Arsimit në Kosovë 2022–2026 dhe politikat sektoriale për arsimin e lartë orientojnë FSI-në drejt digjitalizimit, përmirësimit të cilësisë, zhvillimit kërkimor dhe modernizimit të qasjeve pedagogjike, duke garantuar përputhje me prioritetet kombëtare dhe trendet evropiane.

Si institucion i akredituar, FSI është i obliguar të mbajë të funksionalizuar sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë, të realizojë ciklin vjetor të vetëvlerësimit dhe të raportojë rregullisht pranë Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (AKA). Këto procese sigurojnë monitorimin sistematik të performancës akademike, harmonizimin e programeve me standardet e Bolonjës, zhvillimin e kurrikulës sipas kërkesave bashkëkohore dhe mobilitetin e stafit dhe studentëve.

Organet drejtuese të FSI-së, Këshilli Mësimor-Shkencor dhe Dekanati mbështesin strukturën e qeverisjes akademike dhe administrative, hartimin e politikave, menaxhimin e burimeve, zhvillimin e programeve dhe funksionimin e sistemeve të cilësisë. Këto struktura, të bazuara në Statut dhe legjislacion, krijojnë themelet institucionale mbi të cilat ndërtohet Strategjia e Zhvillimit 2026–2030.

3.2. Studentët, stafi dhe programet akademike

Studentët përbëjnë qendrën e zhvillimit akademik të FSI-së dhe pasqyrojnë diversitetin e komunitetit më të gjerë të Kosovës. Përgjatë viteve të fundit, numri i studentëve ka qenë relativisht stabil, me rreth 410 studentë aktivë në të dy nivelet e studimit. Studentët vijnë nga komuna të ndryshme të Kosovës, me prapavija të ndryshme socio-ekonomike, gjë që pasqyron misionin e FSI-së si institucion publik me rol të rëndësishëm shoqëror. Një sfidë e vazhdueshme mbetet pjesëmarrja më e ulët e grave në krahasim me institucionet tjera të arsimit të lartë, fenomen që lidhet me natyrën teologjike të programeve, por që kërkon qasje të synuar për përfshirje më të madhe të vajzave dhe grave.

Stafi akademik përbëhet nga 26 ligjërues të angazhuar në programe Bachelor dhe Master, me një përzierje të stafit me gradë Master dhe PhD. Stafi ka përvoja të gjera në mësimdhënie dhe angazhim në komunitet, ndërsa pjesëmarrja në kërkim shkencor është në rritje, por ende e kufizuar. Pavarësisht kësaj, FSI ka treguar progres duke stimuluar botimet në revista të indeksuara, pjesëmarrjen në konferenca dhe ngritjen e kapaciteteve përmes bashkëpunimeve ndërkombëtare. Ngarkesa mësimore e stafit mbetet e lartë, çka

kërkon vlerësim periodik të balancës mes mësimdhënies dhe hulumtimit, veçanërisht duke pasur parasysh objektivat strategjike të FSI-së për të rritur cilësinë akademike dhe rezultatet kërkimore.

Stafi administrativ, i përbërë nga 6 punonjës, siguron funksionalitet të përditshëm të proceseve institucionale, duke mbështetur administrimin e studentëve, arkivën, bibliotekën, TI-në dhe cilësinë. Stafi administrativ është i përkushtuar, por ka nevojë për përmirësim në fushat e digjitalizimit, menaxhimit të të dhënave dhe përdorimit të platformës SIMS, e cila është në proces të avancimit për të mundësuar shërbime të plota akademike online.

Programet studimore në nivel Bachelor dhe Master janë të akredituara dhe orientohen në teologji islame, jurisprudencë islame, shkenca shoqërore të lidhura me fenë, histori dhe kulturë islame, si dhe edukim fetar.

Sa i përket performancës akademike, të dhënat institucionale tregojnë se shkalla e kalueshmërisë në nivel Bachelor luhet mes 78% dhe 85%, ndërsa në nivel Master mbetet 100%. Shkalla e braktisjes është e ulët, çka dëshmon për stabilitet akademik dhe përcjellje të rregullt të progresit të studentëve nga stafi.

Infrastruktura e FSI-së përfshin hapësira të mjaftueshme për mësimdhënie, kërkim dhe aktivitete studentore, megjithëse disa ambiente kërkojnë modernizim. Fakulteti ka investuar në përmirësimin gradual të sallave të ligjërimit, kabinetëve të profesorëve dhe hapësirave studentore. Biblioteka, e pasur me literaturë teologjike dhe shkencore, ka nevojë për digjitalizim të plotë dhe zgjerim të koleksioneve në gjuhë të huaja. Pajisjet teknologjike (kompjuterë, laptopë, Smart Boards, projektorë) janë të pranishme dhe shfrytëzohen vazhdimisht nga stafi akademik në afrimin e mësimdhënjes. Platforma SIMS, e cila menaxhon të gjitha proceset akademike, është në fazë të avancimit për integrimin e moduleve të vlerësimit dhe administrimit të cilësisë.

Burimet financiare të FSI-së mbeten të kufizuara dhe varen kryesisht nga BIK, me kapacitet të ulët për sigurimin e projekteve kërkimore ndërkombëtare dhe fondeve të jashtme. Kjo krijon kufizime në zhvillimin e kapaciteteve kërkimore, modernizimin teknologjik dhe zgjerimin e mobilitetit ndërkombëtar. Megjithatë, Fakulteti ka nisur hapa të qëndrueshëm drejt zhvillimit të partneriteteve, përfshirë marrëveshjet ndërkombëtare Erasmus+ dhe bashkëpunimin me institucione simotra në rajon, të cilat përbëjnë një potencial të rëndësishëm për rritjen e mëtejshme të cilësisë akademike.

3.3.Sfidat dhe mundësitë e mjedisit

Mjedisi politik në të cilin funksionon FSI karakterizohet nga ndryshime të vazhdueshme në kornizën ligjore për institucionet e arsimit të lartë, të cilat kërkojnë përshtatje të vazhdueshme dhe rritje të transparencës e llogaridhënies. Në aspektin social dhe kulturor, vërehet një rritje e interesit për programe studimore që lidhen me etikën, kulturën, edukimin dhe dialogun shoqëror, ndërkohë që roli i Islamit në shoqëri e rrit potencialin e FSI-së për të ushtruar ndikim pozitiv dhe për të kontribuar në zhvillimin kulturor dhe shpirtëror të komunitetit.

Nga perspektiva ekonomike, tregu i punës kërkon profesionistë fetarë të kualifikuar, por njëkohësisht kërkon edhe aftësi bashkëkohore si teknologjia, komunikimi dhe kompetencat ndërpersonale. Kufizimet

buxhetore mbeten një sfidë që ndikon në zhvillimin e kapaciteteve institucionale, kërkimit dhe inovacionit. Ndërkohë, mjedisi teknologjik po transformohet me ritme të shpejta, duke krijuar mundësi të reja për integrimin e platformave digjitale në procesin mësimor, zhvillimin e Smart Classrooms dhe zgjerimin e qasjeve moderne në mësimdhënie. Ky transformim paraqet një mundësi të rëndësishme për FSI-në që të avancojë cilësinë e ofrimit akademik dhe të përmbushë pritjet e studentëve dhe të tregut të punës.

3.4. Analiza SWOT

Analiza SWOT ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që ndikojnë në funksionimin dhe zhvillimin e Fakultetit të Studimeve Islame. Kjo analizë, e mbështetur në dokumentet zyrtare të fakultetit dhe në konsultimet me aktorët institucionalë, shërben si bazë për formulimin e objektivave dhe masave strategjike të Planit Strategjik 2026–2030.

Anët e forta: Anët e forta të FSI-së përbëjnë bazën strategjike mbi të cilën ndërtohet zhvillimi afatgjatë i institucionit. FSI ofron programe studimi unike në Kosovë, duke u pozicionuar si institucioni kryesor në fushën e studimeve islame. Stafit akademik përbëhet nga profesorë të kualifikuar me përvojë të gjerë kombëtare dhe ndërkombëtare, ndërsa studentët vijnë nga zona të ndryshme të vendit dhe rajonit, duke sjellë diversitet kulturor dhe akademik.

FSI gëzon një infrastrukturë moderne, përfshirë bibliotekën e pasur, amfiteatrin, sallat bashkëkohore të mësimi, si dhe hapësirat mbështetëse si konvikti dhe kantina, të cilat ofrojnë kushte optimale për studim, mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Diplomës së FSI-së i njihet vlefshmëria brenda dhe jashtë vendit, duke forcuar besueshmërinë dhe atraktivitetin e institucionit.

Reputacioni rajonal dhe ndërkombëtar i FSI-së është ndërtuar mbi traditën e tij akademike, kontributin afatgjatë në shërbim të komunitetit dhe rolin aktiv në promovimin e dialogut ndërfaqësor dhe ndërkulturor. FSI ruan trashëgiminë islame në Kosovë, duke e kombinuar këtë me qasje bashkëkohore në arsimin e lartë. Financimi i vazhdueshëm nga BIK, mbështetja për kërkimin shkencor, organizimi i konferencave dhe bursat meritore të ofruara për studentët me rezultate të larta e bëjnë FSI-në një institucion të qëndrueshëm, të orientuar drejt cilësisë dhe zhvillimit të vazhdueshëm.

Anët e dobëta: Megjithatë FSI ka potencial të konsiderueshëm për zhvillim, disa anë të dobëta të brendshme paraqesin sfida strukturore që kërkojnë ndërhyrje të drejtpërdrejtë dhe strategjike. Produktiviteti i kërkimit mbetet i ulët, me numër të pamjaftueshëm publikimesh në revista me impakt shkencor dhe indeksim ndërkombëtar (Scopus, WoS). Angazhimi i stafit akademik në projekte hulumtuese është i kufizuar, njësoj si edhe pjesëmarrja e institucionit në projekte dhe iniciativa ndërkombëtare, çka redukton mundësitë për bashkëpunim dhe ngritje akademike. Mungesa e profesorëve me volum të mjaftueshëm punimesh shkencore paraqet pengesë për hapjen e drejtimeve të reja studimore dhe për zgjerimin e portofolit akademik. Po ashtu, kapacitetet administrative nuk janë të mjaftueshme për të mbështetur zgjerimin institucional dhe proceset në rritje, ndërkohë që digjitalizimi i shërbimeve dhe procedurave mbetet i paplotësuar.

Në aspektin akademik, mungesa e lëndëve të edukimit dhe pedagogjisë krijon boshllëqe në përgatitjen e studentëve për profesionet arsimore, duke ndikuar në zhvillimin e kompetencave didaktike. Një sfidë tjetër është mungesa e dialogut të strukturuar dhe të rregullt ndërmjet FSI-së, Bashkësisë Islame të Kosovës dhe institucioneve shtetërore, e cila e kufizon koordinimin institucional dhe mundësinë për të ndikuar në politikatat përkatëse.

Mundësitë: FSI operon në një mjedis të jashtëm dinamike që ofron një gamë të gjerë mundësish strategjike për zhvillim akademik, institucional dhe shoqëror. Transformimi digjital dhe rritja e kërkesës për mësim online krijojnë hapësira të rëndësishme për modernizimin e ofertës mësimore dhe për integrimin e formave fleksibile të të nxënit. Ekziston potencial i konsiderueshëm për zhvillimin e kurseve afatshkurtra joformale, programeve të reja dhe specializimeve, përfshirë edhe mundësinë e hapjes së programit të doktoraturës, i cili do të rriste më tej profilin akademik të fakultetit. Iniciativat dhe programet ndërkombëtare, si Erasmus+, mobilitetet për staf dhe studentë, si dhe projektet rajonale e globale të bashkëpunimit, ofrojnë mundësi të mëdha për rritjen e kapaciteteve profesionale, shkëmbimin akademik dhe ndërkombëtarizimin e FSI-së. Në nivel vendor, përfshirja e edukimit fetar në shkollat e Kosovës krijon një kërkesë të re për profesionistë të kualifikuar në arsimin fetar dhe etik, duke e pozicionuar FSI-në si institucionin udhëheqës për përgatitjen e këtij profili.

Funksionalizimi i Akademisë për Lidership dhe Studime Islame paraqet një mundësi të rëndësishme për zhvillimin e programeve të avancuara të trajnimit dhe për forcimin e ndikimit të FSI-së në komunitetin profesional dhe shoqëror. Rritja e interesit për fusha si etika, kultura, dialogu ndërfetar dhe lidhshipi fetar krijon dritare të reja për bashkëpunime, projekte dhe iniciativave ndërshtetërore që mund të avancojnë misionin dhe rolin e FSI-së në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Kërcënimet: FSI përballet me një sërë kërcënimesh të jashtme që ndikojnë potencialisht në funksionimin dhe zhvillimin e tij afatgjatë. Migrimi i vazhdueshëm i popullsisë dhe zvogëlimi i numrit të maturantëve krijojnë presion mbi regjistrimet e reja dhe qëndrueshmërinë demografike të studentëve. Ndryshimet e shpeshta ligjore dhe rritja e kërkesave nga Agjencia e Akreditimit vendosin standarde gjithnjë e më të larta për stafin akademik, programet dhe sistemet e brendshme të cilësisë, duke kërkuar investime të vazhdueshme në kapacitete dhe dokumentacion.

Vështirësitë në punësimin e studentëve dhe të diplomuarve në tregun vendor mbeten një sfidë strukturore, e cila ndikon në perceptimin e vlerës së studimeve dhe në tërheqjen e kandidatëve të rinj. Paqartësitë lidhur me statusin juridik të FSI-së si institucion i arsimit të lartë me traditë, por i pozicionuar jashtë sistemit të rregullt publik krijojnë kufizime në bashkëpunime, financim dhe planifikim afatgjatë. Po ashtu, konkurrenca në rritje nga institucionet private të arsimit të lartë, si dhe nga platformat e të nxënit online, shton presionin për inovacion, dallueshmëri akademike dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së ofertës arsimore.

4. Vizioni, Misioni dhe Vlerat

Ky kapitull përcakton identitetin strategjik të FSI-së për periudhën 2026–2030 dhe paraqet bazën orientuese për të gjitha objektivat, prioritetet dhe masat zhvillimore të parapara në këtë plan. Përmes vizionit, misionit dhe vlerave, FSI artikulon qartë drejtimin e tij institucional, pritjet afatgjata dhe parimet mbi të cilat ndërtohet funksionimi akademik, kërkimor dhe shoqëror.

Misioni, vizioni dhe vlerat janë formuluar duke reflektuar traditën akademike të FSI-së, rolin që ai ka në sistemin e arsimit të lartë në Kosovë dhe përgjegjësinë e tij historike dhe bashkëkohore për formimin e kuadrove profesionale në fushën e studimeve islame. Këto elemente udhëheqëse janë rezultat i një procesi të gjerë dhe konsultativ që përfshiu stafin akademik e administrativ, studentët, alumnit dhe partnerët institucionalë, duke siguruar që identiteti strategjik të jetë i rrënjësor në nevojat reale të institucionit dhe pritjet e komunitetit të gjerë.

Në tërësi, ky kapitull krijon kuadrin konceptual mbi të cilin mbështetet i gjithë Plani Strategjik. Ai garanton koherencë të brendshme dhe ndërlidhje organike ndërmjet identitetit institucional dhe objektivave strategjike, duke i mundësuar FSI-së të avancojë si institucion modern, i qëndrueshëm dhe me ndikim të qëndrueshëm akademik e shoqëror.

4.1. Vizioni i FSI

FSI synon të jetë qendër lidhëse akademike dhe kërkimore që ofron arsim cilësor, duke ndërthurur traditën islame me nevojën moderne dhe duke formuar intelektualë të ndërgjegjshëm që kontribuojnë në zhvillimin etik, kulturor dhe social të komunitetit lokal dhe ndërkombëtar.

Ky vizion reflekton aspiratën e FSI-së për t'u pozicionuar si institucion referent në fushën e studimeve islame dhe shkencave shoqërore të lidhura me to. Vizioni thekson standardet e larta akademike, orientimin drejt zhvillimit shkencor dhe inovacionit, domosdoshmërinë e modernizimit dhe digjitalizimit, si dhe rolin e rëndësishëm të Fakultetit në dialogun shoqëror, etik dhe kulturor. Ai gjithashtu nënvizon nevojën për ndërkombëtarizim, bashkëpunim të gjerë institucional dhe rritjen e ndikimit shoqëror të FSI-së.

4.2. Misioni i FSI

FSI ka për mision të ofrojë arsim të lartë cilësor dhe gjithëpërfshirës, të zhvillojë kërkime shkencore me ndikim akademik e shoqëror dhe të shërbejë komunitetin me vlera islame, etike dhe humane, duke përgatitur kuadro profesionale.

Misioni i FSI-së është të ofrojë arsim të lartë cilësor dhe gjithëpërfshirës, të zhvillojë kërkime shkencore me ndikim akademik dhe shoqëror dhe të shërbejë komunitetin përmes promovimit të vlerave islame, etike dhe humane, duke përgatitur kuadro profesionale dhe të përgjegjshme. Duke u mbështetur në tri shtyllat themelore të universiteteve moderne: mësimdhënie cilësore, kërkim shkencor dhe shërbim ndaj

komunitetit, FSI synon të formojë profesionistë të aftë dhe etikë, të kontribuojë në zhvillimin e dijes në fushën e studimeve islame dhe shkencave humane, si dhe të luajë një rol aktiv në institucionet dhe shoqërinë kosovare përmes ekspertizës profesionale dhe angazhimit qytetar.

4.3.Vlerat e FSI

FSI udhëhiqet nga një kulturë institucionale e bazuar në vlera akademike që garantojnë integritet, cilësi dhe profesionalizëm në të gjitha dimensionet e funksionimit të tij. Këto vlera përfaqësojnë themelet mbi të cilat ndërtohet identiteti i Fakultetit dhe orientimi i tij strategjik për periudhën 2026–2030.

Vlerat që udhëheqin FSI-në janë:

1. Cilësia Akademike

Përkushtim ndaj standardeve të larta të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe zhvillimit profesional.

2. Integriteti Akademik

Respektim i etikës profesionale, ndershmërisë intelektuale dhe parimeve të përgjegjësisë akademike.

3. Profesionalizmi

Angazhim i stafit dhe studentëve për të vepruar me kompetencë, përgjegjësi dhe etikë në çdo aktivitet akademik dhe administrativ.

4. Përfshirja dhe Barazia

Ndërtimi i një mjedisi akademik të hapur, të drejtë dhe gjithëpërfshirës, ku çdo individ trajtohet me respekt dhe pa diskriminim.

5. Inovacioni në Arsimin e Lartë

Aplikimi i metodave bashkëkohore pedagogjike dhe përdorimi i teknologjive digjitale për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe të të nxënit.

6. Përgjegjësia Shoqërore

Angazhim në promovimin e vlerave qytetare, mirëqenies së komunitetit dhe dialogut ndërfetar si pjesë e rolit institucional.

7. Bashkëpunimi

Kultivimi i partneriteteve të qëndrueshme akademike, institucionale dhe ndërkombëtare që mundësojnë zhvillim të përbashkët dhe shkëmbim të njohurive.

Këto vlera përbëjnë bazën e kulturës institucionale të FSI-së dhe udhëheqin zbatimin e misionit dhe vizionit të tij, duke e orientuar fakultetin drejt një institucioni modern, të hapur dhe me ndikim të qëndrueshëm shoqëror.

5. Objektivat Zhvillimore

Objektivat zhvillimore të FSI-së për periudhën 2026–2030 paraqesin drejtimet kryesore strategjike që institucioni synon të ndjekë për të forcuar rolin e tij akademik, kërkimor dhe shoqëror. Këto objektiva janë formuluar mbi bazën e një analize të thelluar të gjendjes aktuale, e cila përfshiu vlerësimin e kapaciteteve të brendshme, sfidave strukturore, mundësive të mjedisit, si dhe pritjeve të aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm duke u udhëhequr nga parimet e përfshirjes, transparencës dhe vendimmarrjes së bazuar në evidencë, duke reflektuar qasjen moderne të planifikimit strategjik.

FSI përmes pesë objektivave të përcaktuara synon të krijojë një mjedis akademik që promovon cilësi të lartë mësimdhënieje, prodhim shkencor të qëndrueshëm, mobilitet ndërkombëtar, qasje të integruar në zhvillimin e politikave fetare dhe shoqërore, si dhe një kulturë institucionale të bazuar në efikasitet, transparencë dhe zhvillim të vazhdueshëm. Objektivat janë konceptuar në mënyrë të tillë që të garantojnë matshmëri përmes indikatorëve të qartë, zbatueshmëri përmes masave të përcaktuara dhe ndikim afatgjatë në përmbushjen e misionit të Fakultetit.

Në thelb, objektivat zhvillimore përbëjnë arkitekturën strategjike të planit dhe shërbejnë si mekanizëm udhëheqës për të gjitha proceset akademike, administrative dhe kërkimore të institucionit gjatë periudhës 2026–2030, duke siguruar që FSI të ecë drejt një modeli modern dhe të konsoliduar të arsimit të lartë.

Lista e objektivave zhvillimore:

1. Përmirësimi i cilësisë akademike dhe inovacionit në mësimdhënie
2. Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore dhe publikimeve shkencore
3. Ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi institucional
4. Forcimi i lidhjes me komunitetin dhe tregun e punës
5. Zhvillimi institucional dhe qëndrueshmëria

1. Përmirësimi i cilësisë akademike dhe inovacionit në mësimdhënie

Ky objektivi synon të forcojë themelet akademike të FSI-së duke modernizuar ofertën e programeve, duke avancuar qasjet pedagogjike dhe duke integruar teknologjitë digjitale në procesin mësimor. Përmirësimi i cilësisë akademike kërkon që FSI të përshtatë vazhdimisht kurrikulën me zhvillimet bashkëkohore të tregut të punës, me prirjet shkencore dhe me nevojat e komunitetit, duke siguruar që studentët të marrin njohuri

dhe kompetenca të aplikueshme dhe relevante. Objektivi gjithashtu synon të krijojë kushte për zhvillimin profesional të vazhdueshëm të stafit akademik, nëpërmjet trajnimeve, shkëmbimit të praktikave të mira dhe përdorimit të metodave inovative të mësimdhënies.

Përmes këtyre veprimeve, FSI synon të ndërtojë një kulturë akademike dinamike, inovative dhe të orientuar drejt cilësisë, e cila jo vetëm rrit nivelin e mësimdhënies, por edhe forcon përgatitjen profesionale dhe etike të studentëve, duke i pajisur ata me aftësitë e duhura për të qenë kontribuues të vlefshëm në shoqëri dhe në institucionet ku do të angazhohen.

Objektivi zhvillimor 1: Përmirësimi i cilësisë akademike dhe inovacionit në mësimdhënie	
Qëllimi: Të rritet cilësia akademike dhe të modernizohet mësimdhënia përmes inovacionit pedagogjik, digjitalizimit dhe përfshirjes aktive të studentëve.	
Rezultatet e pritshme • Programet e studimit modernizohen rregullisht dhe përshtaten me kërkesat e tregut të punës. • Rritet në mënyrë të qëndrueshme përdorimi i mësimit digjital dhe platformave online. • Stafi akademik përfiton trajnime të vazhdueshme pedagogjike dhe profesionale. • Rritet kënaqshmëria e studentëve dhe angazhimi i tyre aktiv në procesin e të nxënit. • Rritet angazhimi i studentëve dhe stafit në projekte hulumtuese dhe aktivitete akademike.	
Masat	Indikatorët
1.1. Rishikimi dhe vlerësimi vjetor i programeve të studimit dhe përshtatja me nevojat e tregut të punës.	1. Të gjitha programet e studimit të rishikuara së paku një herë deri në vitin 2030. 2. Minimumi 80% e lëndëve të harmonizuara me kërkesat e tregut të punës deri në 2030.
1.2. Integrimi i mësimit digjital dhe platformave online në procesin akademik.	1. Të paktën 50% e lëndëve të mbështetura nga platforma digjitale deri në 2030. 2. Deri në vitin 2030, minimum 20% e lëndëve në programin e masterit ofrohen në format hibrid. 3. Syllabuset e të gjitha lëndëve të publikohen online çdo vit akademik.
1.3. Zhvillimi profesional i stafit për pedagogji bashkëkohore dhe metoda inovative të mësimdhënies	1. Minimumi 2 trajnime pedagogjike në vit për stafin akademik. 2. Deri në 5 trajnime të subvencionuara në vit për stafin akademik dhe administrativ. 3. Raport vjetor i zhvillimit profesional të stafit i përgatitur dhe i miratuar çdo vit.

1.4. Rritja e përfshirjes së studentëve në procesin e të nxënës dhe mekanizmat e feedback-ut.	1. $\geq 90\%$ e studentëve shprehin kënaqësi me mësimdhënien (anketim vjetor).
1.5 Inkurajimi i studentëve dhe stafit për pjesëmarrje në projekte kërkimore	- Deri në 3 projekte kërkimore të subvencionuara çdo vit. - Rritje me 20% e punimeve/projekteve të studentëve të prezantuara në aktivitete akademike deri në 2030. - Deri në vitin 2027, Rregullorja për veprimtarinë kërkimore-shkencore përditësohet duke përfshirë edhe pjesën për projektet hulumtuese.
1.6. Zgjerimi i literaturës akademike përmes përkthimeve dhe burimeve digjitale.	- Rritje deri në 50% (minimum) e koleksionit të literaturës në shqip në bibliotekë deri në 2030. - Platformë digjitale për qasje në literaturë të përditësuar funksionale deri në vitin 2027.

2. Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore dhe publikimeve shkencore

Ky objektivi synon të ndërtojë një kulturë të qëndrueshme kërkimore brenda FSI-së dhe të rrisë dukshëm ndikimin shkencor të institucionit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Duke pasur parasysh rëndësinë e kërkimit shkencor në arsimin e lartë modern, FSI synon të krijojë një mjedis ku kërkimi, analiza dhe prodhimi i dijes bëhen pjesë qendrore e punës akademike të stafit dhe studentëve. Përmes të infrastrukturës kërkimore dhe ofrimit të mbështetjes financiare për botime e konferenca, fakulteti synon të rrisë cilësinë dhe sasinë e publikimeve, duke inkurajuar paraqitjen e punimeve në revista të indeksuara (Scopus, Web of Science) dhe forume shkencore ndërkombëtare. Kjo qasje jo vetëm forcon kredibilitetin akademik të FSI-së, por edhe kontribuon në avancimin e studimeve islame dhe shkencave humane në Kosovë dhe më gjerë.

Një element i rëndësishëm i këtij objektivi është përfshirja aktive e studentëve, veçanërisht atyre të ciklit të dytë, në projekte kërkimore, publikime dhe konferenca. Kjo përfshirje jo vetëm rrit kapacitetet e tyre akademike, por gjithashtu krijon një brez të ri kërkuesish të përgatitur profesionalisht dhe me orientim shkencor.

Zgjerimi i bashkëpunimeve kërkimore me universitete, institucione dhe qendra studimore rajonale e ndërkombëtare pritet të krijojë mundësi të reja për projekte të përbashkëta, grante, shkëmbime profesionale dhe zhvillim të mëtejshëm të kapaciteteve të stafit. Në këtë mënyrë, FSI synon të pozicionohet si një aktor i rëndësishëm në hartën akademike të rajonit dhe të kontribuojë në zhvillimin e dijes dhe diskursit bashkëkohor në fushën e studimeve islame.

Objektivi Zhvillimor 2: Zhvillimi i kapaciteteve kërkimore dhe publikimeve shkencore	
Qëllimi: Të forcohet kultura kërkimore dhe ndikimi shkencor i FSI-së në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.	
Rezultatet e pritshme - Rritje e publikimeve shkencore me cilësi dhe impakt më të lartë. - Përfshirje më e madhe e studentëve të ciklit të dytë në veprimtari kërkimore. - Rritje e pjesëmarrjes në konferenca, projekte kërkimore dhe rrjete akademike. - Funksionalizim i strukturave të qëndrueshme mbështetëse për kërkimin shkencor.	
Masat	Indikatorët
2.1. Nxitja e publikimeve në revista të indeksuara (Scopus, WoS) dhe pjesëmarrja në konferenca shkencore.	- Rritje deri në 50% e numrit të publikimeve të indeksuara deri në vitin 2030. - Deri në 5 publikime të indeksuara në vit nga stafi akademik. - Minimumi 2 prezantime në konferenca ndërkombëtare për çdo vit.
2.2. Përfshirja e studentëve të masterit në projekte kërkimore.	- Të paktën 1 projekt kërkimor nga studentët çdo vit. - Të paktën 10 punime studentore të prezantuara në konferenca ose revista të brendshme të FSI apo të ngjashme deri në vitin 2030.
2.3. Mbështetje financiare për pjesëmarrje në konferenca dhe botime.	- Subvencionim për publikime në revista të indeksuara në Scopus/WoS dhe pjesëmarrje në konferenca ndërkombëtare. - Të paktën 1 aplikim vjetore për grante kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit.
2.4. Krijimi i Grupit Hulumtues të Studentëve.	- Grupi hulumtues aktiv dhe funksional deri në vitin 2027. - Mbështetje për Organizimi i një Konference të Studentëve Hulumtues deri në 2030.
2.5. Publikimi i revistës shkencore të "Buletini" FSI-së.	- Revista shkencore e indeksuar në CEEOL - Botimi i 2 numrave të revistës çdo vit. - Indeksi në EBSCO deri në vitin 2028.

3. Ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi institucional

Ky objektiv synon të forcojë dhe zgjerojë dimensionin ndërkombëtar të FSI-së, duke e pozicionuar atë si një aktor aktiv dhe të njohur në rrjetet akademike rajonale dhe globale përmes bashkëpunimeve të strukturuar dhe pjesëmarrjes së gjerë në iniciativa ndërkombëtare. Një komponent i rëndësishëm i këtij objektivi është nxitja e mobilitetit të stafit dhe studentëve, përmes programeve Erasmus+, marrëveshjeve bilaterale dhe platformave të tjera ndërkombëtare.

FSI synon gjithashtu të forcojë profilin e tij ndërkombëtar përmes organizimit të konferencave shkencore, forumeve ndërkombëtare dhe simpoziumeve akademike që sjellin së bashku studiues të njohur nga rajoni dhe bota. Një nga nismat më të rëndësishme në kuadër të këtij objektivi është zhvillimi i programit të përbashkët doktoral me Universitetin UTM në Malajzi, i cili shënon një hap të rëndësishëm drejt konsolidimit të identitetit global të FSI-së. Ky program i përbashkët krijon një platformë të avancuar për kërkime ndërkombëtare, rrit cilësinë e arsimit të lartë dhe ofron mundësi të reja për studentë dhe staf.

Përmes këtyre veprimeve, FSI synon jo vetëm të zgjerojë praninë e tij ndërkombëtare, por edhe të ndikojë në mënyrë të qëndrueshme në përmirësimin e cilësisë së arsimit, kërkimit dhe zhvillimit akademik në institucion.

Objektivi Zhvillimor 3: Ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi institucional	
Qëllimi: Të zgjerohet bashkëpunimi akademik dhe kërkimor me institucione rajonale dhe ndërkombëtare.	
Rezultatet e pritshme • Rritet partneriteti ndërkombëtar dhe pjesëmarrja e FSI-së në rrjete akademike. • Zgjerohet mobiliteti i stafit dhe studentëve. • Organizohen rregullisht konferenca dhe aktivitete ndërkombëtare. • Funksionalizohet programi i përbashkët doktoral me UTM. • Përmirësohet reputacioni akademik dhe institucional i FSI-së në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.	
Masat	Indikatorët
3.1. Nënshkrimi i marrëveshjeve të reja ndërkombëtare (Erasmus+, universitete partnere).	1. Përfshirja në të paktën 3 projekte Erasmus+ deri në vitin 2030. 2. Nënshkrimi i minimum 10 marrëveshjeve ndërkombëtare të reja deri në vitin 2030. 3. Të paktën 5 marrëveshje aktive që përfshijnë mobilitete dhe aktivitete të përbashkëta
3.2. Anëtarësimi në asociacione ndërkombëtare të arsimit të lartë	1. Anëtarësimi në të paktën 3 asociacione ndërkombëtare deri në vitin 2030. 2. Pjesëmarrja e stafit në minimum 5 aktivitete të asociacioneve deri në vitin 2030.

3.3. Nxitja e mobilitetit të stafit dhe studentëve.	1. Deri në 10 mobilitete të stafit dhe 10 mobilitete të studentëve deri në vitin 2030.
3.4. Organizimi i konferencave dhe forumeve ndërkombëtare.	1. Organizimi i një konference ndërkombëtare në vit. 2. Organizimi i 2 paneleve, forumeve ose simpoziumeve akademike çdo vit. 3. Pjesëmarrja e të paktën 30 pjesëmarrësve ndërkombëtarë në aktivitetet vjetore.
3.5 Organizimi i një programi të përbashkët doktoral me Universitetin UTM në Malajzi	1. Programi i përbashkët fillon të zbatohet nga viti 2026. 2. Regjistrimi i të paktën 10 studentëve në vit.
3.6. Avancimi i Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare.	1. Hartimi i një Raporti të Ndërkombëtarizimit çdo vit. 2. Rritje deri në 50% e kontakteve dhe partneriteteve institucionale deri në 2030.
3.7. Pjesëmarrja e stafit në aktivitete kërkimore ndërkombëtare dhe projekte të përbashkëta.	1. Të paktën 3 aplikime për projekte ndërkombëtare deri në vitin 2030. 2. Të paktën 3 aktivitete të stafit në aktivitete akademike rajonale ose ndërkombëtare deri në 2030.

4. Forcimi i lidhjes me komunitetin dhe tregun e punës

Ky objektivi synon të zgjerojë dhe thellojë ndikimin shoqëror të FSI-së, duke e pozicionuar atë si një institucion aktiv, të hapur dhe të lidhur ngushtë me nevojat e komunitetit dhe zhvillimet profesionale në tregun e punës. Përmes bashkëpunimit të strukturuar me Bashkësinë Islame të Kosovës, institucionet arsimore, komunat dhe organizatat publike, FSI synon të ofrojë trajnime profesionale, programe ndërgjegjësimi dhe aktivitete që adresojnë nevojat reale të komunitetit. Trajnimet për imamët, mësime të fesë dhe stafin e institucioneve fetare ndihmojnë në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe përmirësimin e shërbimeve komunitare, ndërsa programet e etikës, liderit dhe edukimit qytetar kontribuojnë në ndërtimin e një shoqërie më të ndërgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse.

Përmes aktiviteteve të dialogut ndërfaqësor dhe ndërkulturor, FSI forcon rolin e tij si promotor i paqes, mirëkuptimit dhe bashkëjetesës në një shoqëri që synon stabilitet dhe harmoni. Një komponent kyç i këtij objekti është fuqizimi i lidhjeve me tregun e punës, përmes krijimit të partneriteteve të qëndrueshme me institucione fetare, arsimore dhe publike.

Nëpërmjet këtyre mekanizmave, FSI synon të forcojë rolin e vet si institucion me ndikim të theksuar shoqëror, duke kontribuar në zhvillimin profesional të studentëve dhe duke mbështetur ndërtimin e një komuniteti të fortë, aktiv dhe të orientuar drejt vlerave etike dhe qytetare.

Objektivi Zhvillimor 4: Forcimi i lidhjes me komunitetin dhe tregun e punës	
Qëllimi: Të zgjerohet ndikimi shoqëror i FSI-së përmes partneriteteve të strukturuar me institucionet fetare, arsimore dhe publike, duke rritur relevancën profesionale të studentëve dhe rolin komunitar të fakultetit.	
Rezultatet e pritshme - Akademia për Lidership dhe Studime Islame e funksionalizuar. - Rritje e ndikimit të FSI-së në komunitet dhe institucione publike. - Studentë më të përgatitur profesionalisht dhe me qasje më të mirë në tregun e punës. - Bashkëpunim i qëndrueshëm me BIK, shkolla, komuna dhe institucione publike. - Përmirësohet perceptimi publik për FSI-në si institucion aktiv, shërbyes dhe me rol pozitiv shoqëror. - Promovohet dialogu ndërfetar, etika profesionale dhe edukimi qytetar.	
Masat	Indikatorët
4.1. Funksionalizimi i Akademisë për Lidership dhe Studime Islame	1. Akademia funksionalizohet dhe fillon aktivitetet deri në vitin 2027.
4.2. Ofrimi i trajnimeve të shkurtra për imamët dhe stafin e BIK	2. Ofrimi i deri në 3 trajnimeve vjetore për stafin e BIK dhe për komunitetin. 3. Të paktën 100 pjesëmarrës çdo vit.
4.3. Zhvillimi i programeve të shkurtra trajnuese për edukimit qytetar, etikës profesionale dhe lidershipit fetar.	1. Krijimi i 2 programeve të reja deri në vitin 2028. 2. ≥100 pjesëmarrës në programe deri në vitin 2030. 3. Publikimi i materialeve dhe manualeve mbështetëse.
4.4. Ofrimi i praktikave profesionale për studentët.	1. 100% e studentëve të Bachelor-it të përfshirë në praktikë deri në diplomim. 2. Të paktën 30 institucione partnere për praktikë deri në 2030. 3. Raport vjetor i praktikave me vlerësime të performancës së studentëve.
4.5. Organizimi i aktiviteteve të dialogut ndërfetar dhe shërbimit qytetar.	1. Organizimi i 1 forumi ndërfetar deri në vitin 2030.

	2. Të paktën 4 aktivitete të shërbimit qytetar çdo vit. 3. Përfshirja e ≥ 500 qytetarëve në aktivitetet komunitare.
4.6. Forcimi i lidhjeve me tregun e punës dhe punëdhënësit.	1. ≥ 10 partneritete të reja me punëdhënëses deri në vitin 2030. 2. Themelimi i Career Corner deri në 2027. 3. Rritje me $\geq 30\%$ e punësueshmërisë së të diplomuarve deri në vitin 2030.
4.7. Krijimi dhe aktivizimi i rrjetit të alumnive të FSI-së.	1. Platforma e alumnive funksionale deri në vitin 2027. 2. Regjistrimi i ≥ 300 alumnive në platformë deri në 2030. 3. Organizimi i një Takimi Vjetor Alumni çdo vit.
4.8. Zhvillimi i projekteve komunitare në bashkëpunim me BIK, shkolla dhe OJQ.	1. Realizimi i ≥ 5 projekteve komunitare deri në 2030. 2. Publikimi i raportit vjetor “FSI për Komunitetin”.

5. Zhvillimi institucional dhe qëndrueshmëria

Ky objektivi synon të forcojë themelet organizative, teknologjike dhe financiare të FSI-së, duke e orientuar institucionin drejt një funksionimi modern, efikas dhe të qëndrueshëm në afatgjatë. Digjitalizimi i proceseve akademike dhe administrative është një nga shtyllat kyçe të këtij objektivi. Përmes zhvillimit dhe avancimit të sistemeve të informacionit, si SIMS, dhe ofrimit të shërbimeve online, FSI synon të rrisë efikasitetin, transparencën dhe qasjen e studentëve dhe stafit në shërbime cilësore. Ndër tjera, ky objektivi parashihet edhe modernizimin e infrastrukturës fizike, rinovimin e bibliotekës, zgjerimin e koleksioneve digjitale dhe përmirësimin e mjediseve të mësimdhënies dhe mësim nxënies. Po ashtu, zhvillimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, që garanton përputhshmëri me standardet e akreditimit dhe ndihmon në ngritjen e vazhdueshme të performancës institucionale. Përditësimi i rregulloreve, standardizimi i proceseve, dhe vlerësimi sistematik i performancës akademike dhe administrative.

Një tjetër dimension thelbësor i këtij objektivi është siguri i qëndrueshmërisë financiare. Përmes diversifikimit të burimeve të financimit, zhvillimit të projekteve ndërkombëtare, rritjes së të ardhurave vetanake dhe bashkëpunimeve strategjike, FSI synon të krijojë një bazë financiare stabile që mundëson implementimin e iniciativave zhvillimore dhe investimeve afatgjata.

Në thelb, ky objektivi synon të transformojë FSI-në në një institucion më të fuqizuar, më modern dhe më të qëndrueshëm, që funksionon mbi standarde të avancuara organizative e financiare dhe që është plotësisht i gatshëm t’u përgjigjet kërkesave dhe sfidave të ardhshme të arsimit të lartë.

Objektivi Zhvillimor 5: Zhvillimi institucional dhe qëndrueshmëria

Qëllimi: Të forcohet kapaciteti organizativ, financiar dhe teknologjik i FSI-së, duke siguruar funksionim efikas, transparencë, cilësi dhe qëndrueshmëri afatgjatë.

Rezultatet e pritshme

- Statuti i FSI-së rishikohet dhe harmonizohet me standardet bashkëkohore.
- Rriten kapacitetet akademike, administrative dhe teknologjike të institucionit.
- Digjitalizohen shërbimet akademike dhe administrative duke rritur efikasitetin dhe qasjen e përdoruesve.
- Modernizohet infrastruktura fizike dhe funksionalizohet plotësisht biblioteka si qendër akademike mbështetëse.
- Diversifikohen burimet financiare dhe forcohet stabiliteti financiar i FSI-së.
- Përmirësohet performanca e stafit dhe rritet transparencja.

Masat	Indikatorët
5.1. Rishikimi i statutit të FSI	1. Statuti i FSI i rishikuar deri në vitin 2027
5.2. Digjitalizimi i proceseve akademike dhe administrative.	1. $\geq 80\%$ e shërbimeve të ofruara online deri në vitin 2030. 2. Avancimi i SIMS-it duke integruar shërbime të reja. 3. Implementimi i arkivit elektronik deri në vitin 2028.
5.3. Modernizimi i infrastrukturës dhe burimeve bibliotekare.	1. Biblioteka e rinovuar dhe sistemi i bibliotekës së hapur online funksional deri në vitin 2027. 2. Rritje me $\geq 50\%$ e koleksioneve digjitale.
5.4. Forcimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	1. Raport vjetor i vetëvlerësimit i përgatitur dhe dorëzuar çdo vit. 2. Avancimi i software-it SIMS për të mundësuar vlerësimin e përfomancës së lëndës dhe profesorit. 3. Përditësimi i Rregullores për Sigurim të Cilësisë deri në vitin 2026.
5.5. Krijimi i mekanizmave për sigurim financiar afatgjatë.	1. Të paktën 3 burime të reja të financimit deri në vitin 2030. 2. ≥ 2 projekte ndërkombëtare të miratuara deri në vitin 2030.
5.6. Zhvillimi profesional i stafit administrativ.	1. ≥ 3 trajnime vjetore për stafin administrativ dhe mbështetës.

	2. $\geq 90\%$ e stafit administrativ të trajnuar deri në vitin 2030.
5.7. Përmirësimi i komunikimit institucional dhe transparencës.	1. Publikimi i raportit vjetor institucional për çdo vit. 2. $\geq 80\%$ e dokumenteve dhe vendimeve publike online. 3. Rregulloja e komunikimit e miratuar deri në vitin 2027.

6. 6.

6. Zbatimi, Monitorimi dhe Vlerësimi i Strategjisë

Ky kapitull paraqet mekanizmat institucionalë që garantojnë zbatimin efektiv të Planit Strategjik 2026–2030 të FSI-së. Realizimi i objektivave strategjike kërkon koordinim të qartë ndërmjet strukturave të fakultetit, definim të përgjegjësi dhe procese të qëndrueshme monitorimi dhe raportimi. Qasja e zbatimit bazohet në transparencë, llogaridhënie dhe ndarje të mirë-organizuar të detyrave midis njësive funksionale.

6.1.Mekanizmat për Zbatim

Zbatimi i strategjisë mbështetet në një strukturë të qartë institucionale që siguron drejtim, koordinim dhe ekzekutim efektiv të masave strategjike. Rolin kryesor në drejtimin e procesit e ka Dekani, i cili udhëheq zbatimin dhe siguron që veprimet të jenë në përputhje me vendimet e Këshillit Mësimor-Shkencor (KMSH). KMSH mbetet organi më i lartë vendimmarrës, që miraton planifikimin vjetor dhe vlerëson progresin institucional.

Përgjegjësia e zbatimit operativ ndahet ndërmjet njësive funksionale të FSI-së, të cilat përfshijnë:

- departamentet akademike,
- zyrën e sekretarit,
- zyrën e cilësisë,
- administratën dhe shërbimet teknike,

Secila njësi është përgjegjëse për realizimin e masave dhe indikatorëve që lidhen me fushën e saj, si dhe për raportimin periodik të progresit.

Procesi i zbatimit operacionalizohet përmes programimit vjetor. Çdo vit përgatitet dhe miratohet Plani Vjetor i Veprimit, i cili përmban masat konkrete, afatet kohore, indikatorët e performancës dhe njësitë përgjegjëse për zbatimin. Paralelisht, hartohet buxheti vjetor i masave strategjike, i cili siguron mbështetjen financiare për realizimin e objektivave. Në fund të vitit përgatitet Raporti Vjetor i Zbatimit, që pasqyron nivelin e arritjes së objektivave, sfidat e hasura gjatë zbatimit dhe rekomandimet për përmirësim.

6.2. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi i Planit Strategjik përbëjnë një komponent qendror të menaxhimit strategjik të FSI-së, duke siguruar që objektivat dhe masat e përcaktuara të zbatohen në mënyrë të rregullt, efektive dhe në përputhje me zhvillimet institucionale dhe me standardet e arsimit të lartë. Ky proces bazohet në mbledhje të vazhdueshme të të dhënave, analizë sistematike të indikatorëve të performancës dhe transparencë të plotë në vendimmarrje.

Komisioni për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Strategjisë (KMZS), i themeluar me vendim të Dekanit, është përgjegjës për monitorimin periodik të progresit dhe shqyrtimin e realizimit të objektivave. KMZS mban takime gjashtëmujore për të analizuar arritjen e indikatorëve, për të vlerësuar avancimin e njësive funksionale dhe për të propozuar masa korrigjuese kur identifikohen devijime nga planifikimi. Gjetjet e monitorimit paraqiten për shqyrtim në Këshillin Mësimor-Shkencor, duke siguruar bashkërendim institucional dhe llogaridhënie.

Në përfundim të çdo viti akademik përgatitet Raporti Vjetor i Monitorimit të Strategjisë, i cili përfshin vlerësimin e arritjeve sipas indikatorëve, rezultatet kryesore të vitit, sfidat e hasura dhe rekomandimet për përmirësim të proceseve dhe masave. Ky raport shërben si dokumenti kryesor informues për planifikimin vjetor dhe për vlerësimin afatmesëm të strategjisë. Procesi i vlerësimit siguron analizë të thelluar të efektivitetit, efikasitetit, ndikimit dhe qëndrueshmërisë së masave të ndërmarra, me qëllim garantimin e koherencës dhe relevancës së strategjisë 2026–2030. Vlerësimi vjetor analizon nëse masat kanë prodhuar rezultatet e planifikuara, ndërsa vlerësimi i mesëm identifikon nevojën për përditësim të objektivave dhe indikatorëve, duke reflektuar ndryshimet në arsimin e lartë dhe në kontekstin shoqëror.

Mekanizmat e feedback-ut luajnë rol të rëndësishëm në këtë proces, duke siguruar përfshirjen e studenëve, stafit akademik, stafit administrativ, BIK, alumnive dhe partnerëve institucionalë. Anketa vjetore, takimet periodike dhe fokus-grupet kontribuojnë në mbledhjen e informatave të detajuara që pasurojnë procesin e vlerësimit dhe informojnë vendimmarrjen

Duke qenë se Planit Strategjik është ndërtuar mbi masa të qarta dhe indikatorë të matshëm, procesi i monitorimit dhe vlerësimit do të mbështetet kryesisht në analizën e arritjes së këtyre indikatorëve. Çdo masë ka indikatorë të caktuar që tregojnë nivelin e zbatimit të cilët mund të monitorohen me lehtësi çdo vit.

Kjo qasje mundëson:

- monitorim të thjeshtë dhe të matshëm, të bazuar në evidencë konkrete;
- vlerësim progresiv të objektivave përmes agregimit të indikatorëve të masave;
- identifikim të hershëm të devijimeve dhe marrje të masave korrigjuese;
- raportim të qartë dhe transparent për organet drejtuese.

Në këtë kuadër, vlerësimi i planit strategjik do të strukturohet në gjashtë dimensionet, të cilat interpretohen dhe zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes indikatorëve të masave:

1. **Relevanca** – Analizohet duke parë nëse indikatorët e masave adresojnë realisht nevojat e studentëve, tregut të punës, komunitetit dhe politikat kombëtare.
2. **Efektiviteti** – Matet përmes përqindjes së indikatorëve të arritur, duke vlerësuar nëse rezultatet e planifikuara (output-et) po realizohen dhe nëse po kontribuojnë në arritjen e rezultateve të pritshme të objektivave.
3. **Efikasiteti** – Vlerësohet duke lidhur arritjen e indikatorëve me burimet e përdorura (buxhetin, stafin, kohën), për të kuptuar nëse masat janë zbatuar në mënyrë produktive dhe me kosto efektive.
4. **Zbatimi** – Analizon funksionimin e proceseve të implementimit, respektimin e afateve dhe cilësinë e zbatimit të masave, duke u mbështetur në evidencat e indikatorëve (raporte, dokumente, statistika).
5. **Ndikimi** – Vlerëson efektet e përmbledhura të indikatorëve të realizuar në mësimdhënie, kërkim, shërbim komunitar dhe ndërkombëtarizim, duke dalluar ndikimet e drejtpërdrejta dhe afatgjata të masave të ndërmarra.
6. **Qëndrueshmëria** – Analizon nëse indikatorët e arritur krijojnë rezultate që mund të mbahen afatgjatë (p.sh. platforma digjitale, rritja e kapaciteteve të stafit, partneritete të reja, sisteme të reja të cilësisë).

Ky model i vlerësimit siguron një qasje praktike, të matshme dhe të harmonizuar plotësisht me strukturën e objektivave dhe indikatorëve të planit strategjik, duke garantuar monitorim real, të zbatueshëm dhe të besueshëm të progresit institucional.

7. Ndikimi Buxhetor i Strategjisë

Ky kapitull paraqet vlerësimin e ndikimit financiar të zbatimit të Planit Strategjik 2026–2030 dhe përshkruan burimet e financimit, mënyrat e alokimit buxhetor dhe mekanizmat për të siguruar qëndrueshmëri afatgjatë financiare të fakultetit. Ndikimi buxhetor është konceptuar në mënyrë realiste, duke u bazuar në kapacitetet aktuale financiare të FSI-së dhe mundësitë e financimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Zbatimi i objektivave të planit strategjik kërkon buxhet të qëndrueshëm dhe të parashikueshëm. Burimet financiare që do të mbështesin strategjinë ndahen në disa kategori kryesore. Buxheti vjetor institucional siguron financimin bazë për mësimdhënien, administrimin, shërbimet akademike dhe zhvillimin profesional të stafit. Ai mbulon shpenzimet themelore operative dhe mbështet një pjesë të aktiviteteve zhvillimore.

Masat strategjike për periudhën 2026–2030 kërkojnë buxhet të dedikuar për modernizimin e kurrikulës, trajnimin e stafit, digjitalizimin e proceseve akademike dhe administrative, organizimin e konferencave

ndërkombëtare, mobilitetet dhe zhvillimin e mëtejshëm të bibliotekës dhe burimeve elektronike. Një vlerësim i detajuar financiar për secilën masë do të përgatitet çdo vit, duke prioritetizuar masat që janë të realizueshme dhe me ndikim të menjëhershëm.

Alokimi buxhetor do të udhëhiqet nga parimi i priorizimit dhe realizueshmërisë. Masat që lidhen me cilësinë e mësimdhënies, procesin e akreditimit dhe kërkimin shkencor do të marrin prioritet të lartë. Digjitalizimi i proceseve akademike dhe administrative konsiderohet një investim i domosdoshëm për përmirësimin e efikasitetit dhe transparencës institucionale. Masat me kosto të lartë, përmirësimi i infrastrukturës, digjitalizimi etj. do të financohen gradualisht përmes planeve vjetore të investimeve.

7.1. Burimet e financimit

Burimet e brendshme të financimit përfshijnë buxhetin që FSI-ja merr nga Bashkësia Islame e Kosovës (BIK) për financimin e personelit, shërbimeve administrative dhe procesit të akreditimit. Të ardhurat vetanake nga shërbimet akademike, si trajnimet, programet e certifikimit apo publikimet shkencore, përbëjnë një potencial të rëndësishëm për rritjen e pavarësisë financiare. BIK mbetet partner i rëndësishëm në mbështetjen e aktiviteteve akademike dhe studimore.

Burimet e jashtme përbëjnë një komponent kyç të qëndrueshmërisë financiare. FSI do të synojë rritjen e aksesit në programet ndërkombëtare të financimit si Erasmus+, Horizon Europe, Visegrad Grants, si dhe projekte të financuara nga GIZ, ADA dhe USAID në fushën e arsimit. Përtej kësaj, FSI do të kërkojë partneritete me fondacione ndërkombëtare si dhe do të shqyrtoj mundësinë për të marrë donacione tjera për mbështetjen e infrastrukturës, bursave dhe projekteve akademike. Bashkëpunimet me universitetet ndërkombëtare do të shfrytëzohen si burim bashkëfinancimi për konferenca, mobilitetet dhe projekte kërkimore.

7.2. Qëndrueshmëria financiare

Qëndrueshmëria financiare e FSI-së do të ndërtohet mbi një qasje të strukturuar dhe afatgjatë. FSI do të punojë për diversifikimin e burimeve të financimit, rritjen e të ardhurave vetanake nga aktivitetet akademike, forcimin e menaxhimit të projekteve dhe rritjen e efikasitetit institucional për uljen e kostove operative. Përmes planifikimit të kujdesshëm të investimeve, FSI synon të garantojë stabilitet financiar dhe kapacitete të qëndrueshme për realizimin e objektivave strategjike.

FSI do të zgjerojë rrjetin e bashkëpunimeve akademike dhe financiare për të siguruar mbështetje të qëndrueshme për projektet strategjike. Në nivel kombëtar, FSI do të kërkojë partneritete me MASHTI-në, komunat dhe shkollat për projekte të përbashkëta edukimi dhe zhvillimi profesional. Bashkëpunimi me BIK do të synojë mbështetjen e programeve të formimit të imamëve dhe projekteve kërkimore.